




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
 Agjencia Për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës  
 Agencija za Upravljanje Memorijalnih Kompleksa Kosova  
 Agency for the Management of Memorial Complexes of Kosovo

<b>DATË/A:</b>	30.11.2021
<b>REFERENC-Ë:</b>	109/11.21
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Glauk Konjufca- Kryetar i Kuvendit të Kosovës
<b>CC:</b>	Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Mjedis të Kuvendit të Kosovës
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Bislim Zogaj, Drejtor i AMKMK-së 
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Plani Vjetor i Performancës për vitin 2022

**Plani Vjetor i Performancës për vitin 2022**

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 43 paragrafi 3. të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, AMKMK i propozon Komisionit përgjegjës Planin Vjetor të Performancës për vitin e ardhshëm:

### **Detyrat dhe Përgjegjësitë e AMKMK-së**

Agjencia është përgjegjëse për menaxhimin e Komplekseve Memoriale të shpallura me vendim të Kuvendit si Zona me interes të veçantë kombëtarë dhe më karakter historik:

- Projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare;
- Përcakton programet kërkimore - shkencore, aktivitetet dhe manifestimet e ndryshme, që kanë të bëjnë me zonat dhe historinë e tyre;
- Bashkëpunimin me institucionet qeveritare dhe organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, Komunitat përkatëse, Agjencitë turistike, për projektet që kanë të bëjnë me këto zona;
- Krijimin e Veb-faqes dhe mirëmbajtjen e linçeve të veçanta për Komplekse Memoriale, si dhe publikon revistën vjetore;
- Inicimin e procedurës për shpalljen e Zonave me interes të veçantë dhe përgatitë propozim vendimin për miratim në Kuvend;
- Hartimin e planeve hapësinore, urbane dhe rregulluese të Zonave me interes të veçantë, që kanë të bëjnë me Komplekset Memoriale;
- Hartimin e planeve për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale;
- Propozon shpalljen e Zonave më interes të veçantë kombëtarë dhe me karakter historik.

**Aktivitetet e AMKMK-së  
Për vitin 2022**

AMKMK është përgjegjëse për Komplekset Memoriale në kuadër të zonave të veçanta për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

AMKMK gjatë vitit 2022 parasheh të kryej këto punë - aktivitete:

Në kuadër të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme janë këto aktivitete: Financa, administratë - personel, logjistikë, legjislacion, TI – GIS.

Kurse aktivitetet e Prokurimit dhe Çertifikuesi janë në kuadër të zyrës së Drejtorit të AMKMK-së.

Në kuadër të Departamentit të Planifikimit Projektimit dhe Menaxhimit të Komplekseve Memoriale, janë këto aktivitete: planifikimi, ekzekutimi i punimeve, menaxhimi dhe ruajtja e tyre.

**I- Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme gjatë vitit 2022 parasheh të kryej këto aktivitete:**

**1. Administrata, Personeli dhe informimi:**

**Aktivitetet e Njesisë së Burimeve Njerëzore për vitin 2022:**

1. Hartimi i Raportit Vjetor për njësin e burimeve njerëzore të AMKMK-së për vitin 2021 dhe dorëzimi në Kuvend deri me 31.03.2022;
2. Hartimi i Planit Individual të Personelit të AMKMK-së për vitin 2022;
3. Hartimi i Raportit Vjetor 2021 për njësinë e burimeve njerëzore (raport i brendshëm);
4. Hartimi i planit të trajnimeve 2022, sipas nevojave të stafit;
5. Raport për vlerësimin e rezultateve në punë për nëpunësit e AMKMK-së për vitin 2021;
6. Menaxhimi i Sistemit Informativ për Burimet Njerëzore;
7. Zhvillimi i procedurave të rekrutimit sipas Planit Individual të Personelit 2022;
8. Sigurimi i listës së pagave të stafit të institucionit do të përgatitet në pajtim me procedurat ligjore;
9. Planifikimi dhe menaxhimi i të gjitha llojeve të pushimeve të stafit të AMKMK-së;
10. Menaxhimi i dosjeve fizike dhe elektronike të personelit me të dhëna dhe dokumente relevante;
11. Mbështetë punën e Komisionit disiplinor, komisionit për rekrutim;
12. Siguron zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore;

13. Punë të tjera të cilat kërkohen nga DASHC për të raportuar sipas nevojës rreth burimeve njerëzore për gjendjen në AMKMK;
14. Punët për komunikim dhe informimi.

### **Buxheti dhe Financat**

Aktivitetet e divizionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2022:

1. Hartimi i rrjedhës së parasë për vitin 2022, për kategorinë paga & mëditje, mallra e shërbime dhe investime kapitale;
2. Procedimin dhe aprovimin e pagesave në SIMFK, obligimeve, zotimin, shpenzimet sipas afatit ligjor;
3. Raportimi i obligimeve të papaguara gjatë vitit 2021 dhe që barten si obligime në vitin 2022;
4. Barazimi i shpenzimeve të AMKMK-së me Departamentin e Thesarit për vitin fiskal Janar –Dhjetor 2021;
5. Hartimi i Raportit Vjetor Financiar 2021 për Thesarin – MF;
6. Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025 të AMKMK-së;
7. Raporti Vjetor Financiar 2021 për Kuvendin e Kosovës;
8. Raporti dhe pasqyrat financiare 2022 tre mujore, gjashtë mujore dhe nëntëmujore të AMKMK-së;
9. Raportimi mujor i obligimeve të papaguara dhe obligimeve kontraktuale gjatë vitit 2022;
10. Barazimi dhe rikonsulimi i shpenzimeve të AMKMK-së dhe Departamentit të Thesarit për çdo muaj;
11. Hartimi i kërkesave Buxhetore sipas Qarkoreve Buxhetore 01/2023; 02/2023 dhe 03/2023 duke përfshirë planifikimin e buxhetit operativ në sistemin BDMS dhe planifikimin e projekteve kapitale në sistemin e PIP-it;
12. Hartimi i kërkesave për transfere dhe rialokime të mjeteve sipas Udhëzimit Administrativ 05/2019;
13. Funksionalizimi i procesit të të hyrave në K.M “Adem Jashari”, Prekaz;
14. Dorëzimi i kërkesës buxhetore të AMKMK-së për rishikimin buxhetor 2022 në Ministrinë e Financave;
15. Regjistrimi i pasurive në sistemin SIMFK dhe E-pasuria;
16. Menaxhimi i shpenzimit dhe verifikimi i parasë së imët (petty cashit) e avanseve të AMKMK-së;
17. Përmbyllja e vitit fiskal sipas Rregullores 01/2018;
18. Punë të tjera të cilat kërkohen sipas Ligjit të Buxhetit 2022 dhe Rregulloreve Financiare në fuqi për vitin fiskal 2022.

## Legjislacioni

Aktivitetet e legjislacionit që parashihen për vitin 2022 janë:

1. Hartimi i Projekt Rregullore për Përcaktimin e Kritereve për Komplekset Memoriale të Kosovës;
2. Plani për Menaxhimin e Kompleksit Memorial “Adem Jashari” në Prekaz;
3. Hartimi i Projekt Strategjisë dhe Planit të Veprimit të AMKMK-së;
4. Nxjerrja e Akteve nënligjore sipas Ligjit Nr.04/L-146 AMKMK dhe Ligjit Nr.06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
5. Përpilimi i Vendimeve në sfera të ndryshme në Agjenci;
6. Hartimi i Raportit Vjetor të AMKMK-së për vitin 2021;
7. Hartimi i Planit Vjetor të Performancës për vitin e ardhshëm.

Ligji Nr.04/L-146 AMKMK	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Udhëzim Administrativ Nr.01.2014 për Stemën e AMKMK-së</li><li>2. Rregullore nr.05/2016 për Punët në Teren, Punët shtesë</li><li>3.Rreg.Nr.01/2020 për Caktimin e Shpenzimeve të Telefonave Fiks dhe Mobil të AMKMK-së</li><li>4. Rregullore Nr.06/2017 për Krijimin e të Hyrave</li><li>5. Rreg.Nr.01/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në AMKMK</li></ol>
Ligji Nr.06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.	Rregullore (QRK) Nr.01/2021 për Rregullat dhe Mënyrën e Sjelljes së Vizitorëve në Hapësirat e Kompleksit Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

## **Prokurimi**

Aktivitetet e prokurimit që parashihen për vitin 2022:

1. Në konsultim me të gjitha departamentet apo njësitë e kërkesës përgatitë një plan vjetorë të prokurimit dhe vendos kërkesat sipas prioritetit;
2. Hartimi i planit paraprak apo preliminar të aktiviteteve të prokurimit që kanë për t'u zhvilluar në vitin 2022;
3. Hartimi i planit final të prokurimit në bazë të ndarjes buxhetore 15 ditë pas aprovimit të buxhetit për vitin 2022;
4. Përpilimi i Raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2021 sipas kërkesës së KRPP-së. Raporti duhet të përfshijë të gjitha llojet e kontratave me vlerë të madhe, të mesme, të vogël dhe minimale;
5. Menaxhimi me arkivimin dhe sistemimin e dokumenteve të prokurimit;
6. Informimin publik dhe hartimin e raporteve të ndryshme;
7. Zhvillimi i platformës elektronike të e-prokurimit;
8. Ndihmë profesionale stafit në AMKMK;
9. Mirëmbanë dhe arkivon të dhëna për prokurime;
10. Menaxhimi me zyrën e prokurimit, harmonizimi i punëve me Sektorin për Buxhet dhe Financa;
11. Përgjegjësi për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit të AK brenda kompetencave të tij dhe në pajtim me dispozitat e LPP;
12. Procesi i prokurimit administrohet përmes 8 hapave në vijim:
  - Planifikimi i Prokurimit;
  - Parashikimi i Vlerës;
  - Klasifikimi i Kontratës;
  - Përcaktimi i Procedurës së Prokurimit;
  - Përgatitja e Dosjes së Tenderit, Shpallja;
  - Hapja dhe Vlerësimi i Tenderëve;
  - Dhënia dhe Nënshkrimi i Kontratës;
  - Menaxhimi i Kontratës.

Pranimi i kërkesave për prokurim.

Para fillimit të aktivitetit të prokurimit siguron që fondet janë në disponueshmëri dhe të autorizuara me shkrim.

Përcaktimi i Procedurës së Prokurimit:

Siguron që nuk ka kufizime në specifikime, ose TeR, në mënyrë që të sigurohet konkurrenca maksimale;

Përgatitë dokumente parakualifikuese, dosje të tenderit ose kërkesat për kuotim, kushtet e kontratës, dhënie e kontratës, raportet e vlerësimit të tenderëve etj, duke përdorur formularët standard të aprovuar;

Përgatitja e njoftimeve indikativë për vlerat e mëdha për furnizime, shërbime dhe punë.

Njoftimet në KRPP në të dy gjuhët për vlerat e vogla dhe të mesme ndërsa njoftimi në tri gjuhë për vlerat e mëdha.

Organizon dhe menaxhon takimet para-ofertuese, hapjet e tenderëve dhe procesin e vlerësimit.

Rekomandon përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Hapjes së Tenderëve/të Vlerësimit të Tenderëve.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, shqyrton propozimin për kontratë të rekomanduar nga komisioni vlerësues; Pranon/refuzon rekomandimin e propozuar.

Përgatitë dhe publikon dhënien e kontratave.

Përgatitja e draft kontratës, kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

- Nënshkruan kontratat pas rikonfirmimit që informatat financiare nuk kanë ndryshuar substancialisht;
- Dhe në fund përcjellja e realizimit të kontratave;
- Sipas nevojës takime në KRPP, OSHP dhe takime tjera APP.

### **Logjistika**

Aktivitetet e logjistikës për vitin 2022:

1. Ofrimi i ndihmës logjistike për takimet e personelit të Agjencisë;
2. Menaxhimi i inventarit të AMKMK-së;
3. Koordinimi i kërkesave dhe nevojave të Agjencisë për mallra dhe pajisje të zyrës për punë;
4. Menaxhimi i transportit dhe automjeteve të Agjencisë, mirëmbajtje dhe servisim;
5. Bashkëpunimi në përgatitjen dhe hartimin e broshurave dhe revistave të Agjencisë;
6. Mbështetje teknike për pajisjet e stafit (PC);
7. Inventarizimi i zyrave të reja dhe menaxhimi i inventarit;
8. Furnizimi i zyreve me inventar të ri dhe material shpenzues;
9. Ndihmë logjistike Komplekseve Memoriale për furnizim me inventar dhe pajisje;
10. Aktivitetet për Shenjëzimin e Komplekseve Memoriale etj.

## IT- GIS

Punët dhe përgjegjësitë në sektorin e IT-së:

1. Sigurimi dhe mirëmbajtja e projekteve të Teknologjisë Informative me interes të AMKMK-së:
  - 1.1. Sigurimi i rrjetit si dhe telefoni;
  - 1.2. Mirëmbajtja e bazës së të dhënave, routerave, switch-at, dhe rrjetën mobile;
  - 1.3. Mirëmbajtëse e sistemit: e-malit zyrtar, operimi me rrjeta, si dhe instalimi i pajisjeve të IT-së.
  
2. Bashkërendimi i punëve me Divizionin e prokurimit, Shërbimeve të Përgjithshme dhe Financave:
  - 2.1. Përcaktimi i llojit, tipit dhe karakteristikave për furnizimi me pajisje të IT-së;
  - 2.2. Kujdesi dhe kontrollin e pajisjeve e të IT-së;
  - 2.3. Përcaktimi i zotimit të mjeteve financiare për blerjen e pajisjeve të IT-së.
  
3. Kujdes, mirëmbajtje dhe funksionimin e mirëfilltë të listave të telefonave dhe adresave të postës elektronike të AMKMK-së:
  - 3.1. Përpilimi i kërkesave për numëra të ri, si dhe transferim të numrave aktual të Telefonave;
  - 3.2. Përpilimi i kërkesave për hapjen e e-malit për zyrtar të ri në MPB;
  - 3.3. Përkrahja teknike me probleme të ndryshme që mund të paraqiten.
  
4. Mirëmbajtja dhe përditësimi i të dhënave në programin për Menaxhimin e Flamujve:
  - 4.1. Ndërrimi i flamujve të dëmtuar;
  - 4.2. Instalimi i shtyllave të reja;
  - 4.3. Largimi i shtyllave ekzistuese - të dëmtuara;
  - 4.4. Ndërrimi i Sajlave;
  - 4.5. Përditësimi i të dhënave në program.
  
5. Mirëmbajtja dhe përditësimi i bazës së të dhënave në Sistemin GIS:
  - 5.1. Përditësimi i bazës së të dhënave GIS;
  - 5.2. Shpërndarja dhe sinkronizimi i të dhënave nga Baza e GIS në Webfaqe;
  - 5.3. Backup i rregullt i Bazës së të dhënave.



Gjatë mirëmbajtjes së Komplekseve dhe Memorialëve me Flamuj, duhet të ndërrohen: shtyllat ekzistuese me shtylla të reja të ngjyrosen ato ekzistuese sipas kërkesës. Po ashtu të bëhet edhe ndërrimi i sajlave dhe flamujve të llojeve të ndryshme.

Po ashtu, planifikojmë që në vitin 2022 të instalohet sistemi i Video-Vëzhgimit në disa K M dhe të finalizohet sistemi i GIS-it.

Sistemi i Video Vëzhgimit të funksionalizohet në disa nga Komplekset Memoriale më të rëndësishme, që parashihet të vëzhgohen për 24h, 7 ditë, po ashtu të bëhet servisimi dhe menaxhimi i sistemit të video vëzhgimit dhe Serverit të këtij sistemi.

Ndërsa, sa i përket sistemit të SIG (GIS- it), edhe pse shumica K M janë digjitalizuar, do të punohet edhe për K M tjera të cilat nuk janë kryer ende e që parashihet të futen të gjitha këto Komplekse Memoriale në harta dhe digjitalizim.

## **Çertifikuesi**

Aktivitetet e çertifikuesit për vitin 2022:

1. Certifikimi I të gjitha shpenzimeve buxhetore të institucionit;
2. Hartimi I planeve të punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të divizionit/sectorit në pajtim me mbikëqyrësin;
3. Në bashkëpunim me mbikëqyrësin, analizimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe planit të punës të divizionit dhe hartimi i raporteve mbi progresin e arritur;
4. Sigurimi I kushteve të zbatueshmërisë së një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës;
5. Sigurimi që shpenzimi I parasë publike sipas një kontrate publike të bëhet në pajtim me rregullat e KMF-së, dhe që prokurimi është në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin publik;
6. Sigurimi se janë plotësuar kushtet e kontratës para se të bëhet pagesa, dhe që kërkesa për pagesë është e koduar në zërin e duhur të shpenzimeve;
7. Sigurimi që rregullat e KBFP-së dhe dispozitat tjera ligjore janë respektuar gjatë inicimit dhe realizimit të aktivitetit të prokurimit dhe procedimit të shpenzimeve.

## **II. Departamenti i Planifikimit Projektimit dhe Menaxhimit të Komplekseve dhe Memorialeve.**

A. Këtë vit kemi kërkuar të punësojmë punëtorë për të funksionalizuar këtë Departament, duke kërkuar punësimin e dy ( 2 ) arkitektëve dhe dy ( 2 ) inxhinierëve si dhe disa Ciceron, mirëpo nuk na është lejuar të punësojmë asnjë punëtorë. Mirëpo edhe pse MF nuk na ka lejuar mjete për paga dhe mëditje për plotësimin e pozitave të lira, ne do të bëjmë përpjekje për të biseduar me MF dhe MPB duke ju sqaruar nevojën dhe rëndësinë e punësimit të punonjësve të lartë cekur.

Ky departament ka nën menaxhim Projektet Kapitale, për Komplekset Memoriale. Deri sa ky Departament nuk funksionalizohet plotësisht mbetet të menaxhohet nga Drejtori i DFShP-së. Në kuadër të këtij Departamenti jemi duke ndërtuar planifikuar dhe menaxhuar këto Komplekse Memoriale:

1. Kompleksi Memorial “Adem Jashari” Prekaz- Skenderaj:
  - Ekzekutimi i Konservimit të shtëpive të Rezistencës;
  - Hartimi i Planit të Përgjithshëm Urbanistik;
  - Mbjellja e fidanëve, simbol i 59 të rënëve në betejën e 5,6 dhe 7 Marsit;
  - Ndërtimi i Amfiteatrit dhe parkingut;
  - Shpronësimi.
  
2. Mirëmbajtja e K. M. “Adem Jashari” Prekaz.
  
3. Vazhdimi i Ndërtimit - K. M. “Beteja e Koshares” Koshare.
  - Vazhdimi i punimeve të fazës –IV;
  - Mirëmbajtja e K.M “Beteja e Kosharës”.
  
4. Kompleksi Memorial “ZIV Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë- Malet e Berishës.
  - Ekzekutim i punimeve të projektit të përgjithshëm për “ZIV Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë- Malet e Berishës”;
  - Shpronësim i pronave ku do të ekzekutohet projekti i përgjithshëm.
  
5. Ndërtimi i K. M. “Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së, Marinë- Skenderaj.
  - Ekzekutim i punimeve;
  - Mirëmbajtja.

6. K. M. “Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së, Penuhë- Podujevë.
  - Ekzekutim i punimeve;
  - Mirëmbajtje.
7. Ndërtimi i K. M. “Masakra e Raçakut”, Raçak- Shtime.
  - Ekzekutim i punimeve-faza e –IV;
  - Shpronësim;
  - Mirëmbajtja;
  - Projektim i muralit tek varrezat.
8. K. M. “Kulla e Zahir Pajazitit” Orllan- Podujevë.
  - Mirëmbajtja.
9. Kompleksi Memorial “Dëshmorët e Kombit” Vrellë- Istog;
  - Mirëmbajtje;
  - Shpronësim.
10. Memorialit Masakra e familjes Ahmeti - Likoshan – Drenas;
  - Mirëmbajtje;
  - Shpronësim.
11. Kompleksi Memorial “27 Prilli” Meje-Gjakovë.
  - Ekzekutimi i punimeve, faza e IV;
  - Mirëmbajtje.
12. K M “Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së, Malishevë.
  - Mirëmbajtje.
13. Kompleksi i varrezave të dëshmorëve të brigadës 121 të UÇK-së, Ismet Jashari - Kumanova, Kleçkë-Divjakë, Lipjan.
  - Mirëmbajtja e varrezave.
14. Kompleksi memorial “Demë Ahmeti”, Podujevë.
  - Vazhdim i punimeve.
  - Shpronësimi.
15. Mirëmbajtja e kompleksit “Baza e Parë e UÇK-së” Ladovc, Podujevë.
  - Ekzekutim i Punimeve - Parkingu;
  - Mirëmbajtje.

16. Ndërtimi faza e dytë Memoriali “Ibrahim Rugova dhe Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së”- Prishtinë;
  - Projektim.
17. Ndërtimi i Kompleksit Memorial “Shtabi dhe Varrezat e UÇK-së” Gllogjan-Deçan;
  - Ekzekutimi I punimeve ( faza e III );
  - Shpronësim.
18. Memoriali “Dëshmorët e UÇK-së Shqiponjë” - Gjakovë;
  - Ekzekutimi I punimeve.
19. “Rregullimi i Varrezave të Dëshmorëve” dhe mirëmbajtja e tyre në Drenas.
20. Memorialet “Masakra e Izbicës, Rezallës, Likovcit dhe Likoshanit”, Skënderaj dhe Drenas;
  - Mirëmbajtja.
21. Ndërtimi i Kullës te Shkëmbi i Qëndresës së Heroit “Komandant Fehmi Lladrovi” - Gllanasellë – Drenas;
  - Projektim.
22. Masakra e Familjes Deliu dhe Mulliqi, Abri e Epërme - Drenas;
  - Mirëmbajtje.
23. “Varrezat e Dëshmorëve në Kaçanoll dhe Dyz - Podujevë;
  - Mirëmbajtja.
24. Lapidari I masakrës së Burgut të Dubravës – Istog;
  - Ekzekutim i punimeve (faza finale).
25. Lapidari I Dëshmorëve të UÇK-së Komoran – Drenas;
  - Mirëmbajtje.
26. Lapidari “Zahir Pajaziti” Pestovë – Vushtrri;
  - Mirëmbajtje.
27. Memoriali i martirëve, Studime – Vushtrri;
  - Mirëmbajtje.

28. Obelisku i fëmijëve të vrarë Aeroport, Sllatinë - Lipjan – Prishtinë;
  - Projektim;
  - Shpronësim.
29. Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së në Viti dhe Memoriali i Gurësel e Bajram Sylejmanit -Sadovinë -;
  - Mirëmbajtje.
30. Konservimi I Shtëpisë ku është kryer masakra në Poklek të Vjetër – Drenas;
  - Ekzekutimi i punimeve;
  - Shpronësim;
  - Mirëmbajtje.
31. Projekti për Intervenime Emergjente në Komplekse Memoriale- Varreza të Dëshmorëve dhe Martirëve etj;
  - Ekzekutimi i punimeve.
32. Kompleksi i Varrezave “Masakra e Krushës së Madhe”
  - Ekzekutim i punimeve;
  - Mirëmbajtja.
33. “Masakra e Krushës së Vogël - Prizren “;
  - Ekzekutim i punimeve.
34. Bunkeri i Gjon Sereqit, Shipashnicë- Kamenicë;
  - Vazhdim i Ekzekutimit të punimeve.
35. Ngritja e Monumentit Madhor në Gurin e Gradinës në Bjeshkët e Berishës;
  - Projektim.
36. Ndërtimi i Lapidarit të “Tre Dëshmorëve” në Nekoc- Drenas;
  - Ekzekutim të punimeve.
37. Monumenti për Batalionin e -I- të Brigadës 142 UÇK-së- Vushtrri;
  - Ekzekutim të punimeve.
38. Renovimi i Lapidarëve dhe Varrezave në Komunën e Suharekës;
  - Ekzekutim të punimeve.
39. Rregullimi i Lapidarit të Dëshmorit Ahmet Pantina Llozice- Malishevë;
  - Vazhdim i ekzekutimit të punimeve.
40. Konservimi dhe Restaurimi i disa Objekteve të Luftës së UÇK-së dhe objektet ku janë kryer masakrat;

- Projektim;
  - Ekzekutim i punimeve.
41. Lapidari i “Elfete Humollit” Podujevë;
- Ekzekutim të punimeve faza e -II-.
42. Ndërtimi i Pllakës Përkujtimore të Shtabit të UÇK-së, Studenicë- Istog;
- Ekzekutim i punimeve.
43. Konservimi dhe Restaurimi i Kazermës së UÇK-së - Prelofc, Skenderaj;
- Projektim;
  - Ekzekutim i punimeve.
44. Memoriali i Zonës Operative Të Nerodimes- Mollopolc, Shtime;
- Ekzekutim i punimeve.
45. Obelisku i Rexhep Bislimi – Ferizaj;
- Ekzekutim i punimeve.
46. Shtatorja e Hysen Zogjanit - Fushë Kosovë;
- Ngritja e shtatores dhe punimi i bazamentit.
47. Vendosija e Pllakave Informuese në Komplekse Memoriale dhe Memoriale;
- Punimi dhe vendosja tyre.
48. Shtatorja e Isa Kastratit – Kamenicë;
- Ngritja e shtatores dhe punimi i bazamentit.
49. Busti i Nevzat Kryeziut Rogaçicë – Kamenicë;
- Ngritja e bustit.
50. Varrezat e Martirëve – Polac, Skenderaj;
- Ekzekutim i punimeve.
51. K. M i Varrezave të Dëshmorëve – Marinë, Skenderaj;
- Projektim;
  - Ekzekutim i Punimeve;
  - Mirëmbajtje.
52. Memoriali i Dëshmorëve – Pollatë, Podujevë;
- Ekzekutim i punimeve faza-II-.
53. Memoriali “Eksodi Bllaca 99” -Hani i Elezit;
- Ekzekutim i punimeve faza-II-.

54. Memoriali “Foleja e UÇK-së” - Llaushë, Skenderaj:
  - Projektim;
  - Ekzekutim i Punimeve.
55. Busti “Malush Ahmeti” - Rezallë, Skenderaj:
  - Ngritja e bustit.
  
56. Busti i “Fatmir Fazliut” – Skenderaj:
  - Ngritja e bustit.
  
57. Memoriali Shtabi “Kështjella 26” - Halabak, Podujevë:
  - Projektim;
  - Ekzekutim i Punimeve.
58. Varrezat e Dëshmorëve - Tërstenik, Drenas:
  - Projektim;
  - Ekzekutim i punimeve.
59. Lapidari “Agim Ramadani” – Mitrovicë:
  - Ngritja e Lapidarit.
60. Memoriali “Dëshmorët e Hasit” - Has, Prizren:
  - Ekzekutim i punimeve.
61. Memoriali i Dëshmorëve dhe Martirëve - Leskovec, Prizren:
  - Ekzekutim i punimeve.
62. Memoriali i Uçës- dhe rregullimi i lapidarit në Istog dhe Vrelle – Istog:
  - Ekzekutim i punimeve.
63. Monumenti “Isniqi - Kala e Shpëtimit” - Isniq, Deçan:
  - Ekzekutim i punimeve.
  
64. Shpronësimi i pronave në Komplekse dhe Memoriale:
  - Hartimi i Elaborateve të Shpronësimit.
65. Renovimi i Zyreve:
  - Lyerja e zyreve;
  - Ndërtimi i tualeteve.
66. Instalimi i sistemit të kamerave në Komplekse dhe Memoriale.
  - Vendosja dhe mirëmbajtja e sistemit të vëzhgimit.
67. Furnizimi me pajisje të Teknologjisë Informative.
68. Intervenime në rregullimin e shkronjave nëpër Komplekse dhe Memoriale:
  - Gravimi i shkronjave;
  - Përmirësimi;
  - Ngjyrosja.
  
69. Shënjëzimi i Komplekseve dhe Memorialeve:
  - Vendosja e shënjave orientuese.
  
70. Kontraktimi i një gjuhëtari;
  - Përpilimi i teksteve për nevojat e Agjencisë.

**B.** Gjatë vitit 2022 do të punojmë në drejtim të gjetjes së mundësive të financimit edhe të projekteve tjera që veç janë të futura në PIP- sistem dhe që pritet të ngritën duke filluar nga Planifikimi, Ndërtimi dhe në fund Menaxhimi i tyre:

1. Memoriali “Obelisku Afrim Zhitia” Lluga- Podujevë;
2. Memoriali “Dëshmorët” e UÇK-së” Landovicë- Prizren;
3. Konservimi i “Fshati Memorial Strazhë” Kaçanik;
4. Memoriali “Dëshmorët e UÇK-së” Xërxe, Rahovec - mirëmbajtja;
5. Memoriali “ Martirëve Çabrat” Gjakovë - mirëmbajtja;
6. Memoriali “Heroinat” Prishtinë - mirëmbajtja;
7. Shërbimet Inxhinjerike.
8. Mirëmbajtja e shtatoreve;
9. Vendosija e kamerave në disa Memoriale.

Me respekt.